



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

URDHËR

30.7.18

14397

Nr. 213 Datë 30.7 2018

**“MBI  
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT, DREJTORISË  
SË PËRGJITHSHME TË FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E  
BE-së, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË SI DHE TË  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSËS SË PASURISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, të Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 298 dhe nr. 299, datë 23.05.2018 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 28.03.2018, të Urdhrave të Kryeministrit nr. 85 dhe nr. 88, datë 13.06.2018 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit” si dhe “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 62, datë 10.04.2018 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”, i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë;

**URDHËRON:**

1. Të gjitha shërbimet mbështetëse dhe transaksionet financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë do të mbulohen nga aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deri në krijimin e njësisë së shërbimeve mbështetëse në strukturat organike të këtyre drejtorive.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**

